



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 19, par.1, pika “b,c” të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.3.2001, të nenit 3, par.1, pika” b,c” të Rregullores për vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt.11 gusht 2000, Rregullores së UNMIK-ut nr.2003/30, të dt. 10 shtator 2003, dhe të nenit 24, par.3 të Ligjit për planifikim hapësinor nr. 2003/14, të dt. 3.7.2003, në mbledhjen e mbajtur më 29.03.2007, merr

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR CAKTIMIN E
KRITEREVE BAZË PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË PËRDORIMIT TË
HAPËSIRAVE BANESORE

Neni 1

Miratohet Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e kriterëve bazë për ndërrimin e destinimit të përdorimit të hapësirave banesoreme nr. 01-35-2425, të dt. 10.9.2004.

Neni 2

Neni 1 i Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.01-35-2425, të dt. 10. 9.2004, ndryshohet dhe plotësohet me këto paragrafe, ku thuhet: “ Kriteret bazë të këtij Vendimi do të aplikohen vetëm për objektet në rrugët dhe bulevardet si vijon:

- Rr. “Bulevardi Nëna Terezë”, në vazhdimësi “ Bulevardi i Dëshmorëve” gjer te sheshi “Idriz Seferi” (Rrethi);
- Rr. “Agim Ramadani”, nga udhëkryqi te Kuvendi i Kosovës gjer në udhëkryqin ku lidhet me rrugën “ Arkitekt Karl Gega”;
- Rr. “UÇK-ja”;
- Rr. “Fehmi Agani”, prej udhëkryqit ku lidhet rruga” Fazli Graiçevci” gjer në pikën e takimit me rr. “Agim Ramadani”;
- Rr.”Luan Haradinaj” gjer në udhëkryqin me rr. “Garibaldi”, duke depërtuar në sheshin “Edit Durhami”;
- Rr.”Tringë Ismaili”, nga udhëkryqi në bulevardin “Nëna Terezë” gjer te udhëkryqi “Agim Ramadani”;
- Rr.”Migjeni”;
- Rr.” Rexhep Luci”;
- Rr.”Qemail Hoxha” dhe
- Rr.”Garibaldi” nga udhëkryqi në rr.” Luan Haredinaj” gjer te udhëkryqi në bulevardin “Nëna Terezë”.

Ndërrimi i destinimit konform nenit 1, paragrafit 1, në këto rrugë dhe bulevarde do të bëhet vetëm për hapësirat banesore, të cilat kanë qasje nga rrugët dhe bulevardet e lartshënuara.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit të tij në Kuvendin e Komunës, me mundësi rishqyrtimi pas gjashtë muajsh